


## Korniza për vlerësimin e rrezikut – Strategjia per Reformën e MFP

Qëllimi i këtij dokumenti është që ta ofrojë një kornizë për vlerësimin e rrezikut për të siguruar që nivelet e rrezikut dhe paqartësive/pasigurive të identifikohen dhe të menaxhohen si duhet për zbatimin e objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për Reformën e MFP 2016-2020. Ky dokument do ta arrijë këtë duke i përkufizuar si vijon:

- *Procesin i cili duhet të miratohet t'i identifikojë, analizojë dhe vlerësojë rreziqet e lidhura me zbatimin e secilit objektiv/aktivitet;*
- *Si do të zhvillohen dhe përdoren masat për zbutjen e rrezikut për ta zvogëluar gjasën ose ndikimin e rreziqeve;*
- *Rolet dhe përgjegjësitë për adresimin e masave për zbutjen e rrezikut;*

Korniza për menaxhimin e rrezikut është një vlerësim i brendshëm dhe përbëhet prej hapave kryesorë në vijim:



Ky dokument i mbulon të gjitha objektivat që janë të përfshira në Strategjinë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP) në Kosovë 2016-2020. Përshkrimi më i hollësishëm metodologjik i masave e përcjell të njëjtën strukturë sikur edhe në strategji dhe është e ndarë në katër shtylla:

- Shtylla 1: Disiplina fiskale
- Shtylla 2: Efikasiteti i alokimit
- Shtylla 3: Efikasiteti funksional
- Shtylla 4: Çështjet e ndërlidhura të MFP

## 1. Vlerësimi i rrezikut

### a) Identifikimi i rrezikut

Identifikimi i rrezikut përfshin përcaktimin e atyre rreziqeve apo kërcënimeve që ka gjasë të ndikojnë në përmbushjen e objektivave/aktiviteteve prioritare. Këtu përfshihet identifikimi i rreziqeve dhe kërcënimeve që mund të ndikojnë negativisht në arritjen e ndonjë prioriteti specifik, ose mund ta vonojnë përmbushjen e tij<sup>1</sup>. Të kuptuarit dhe analizimi i mjedisit të rrezikut është një hap i rëndësishëm drejt identifikimit të masave për zbutjen e tij dhe për monitorimin e rrezikut.

Në kuadër të këtij seksioni nga përfaqësuesit e caktuar pritet që ta shkruajnë një koment në formë përshkrimi duke e sqaruar se cilat mund të jenë ngjarjet apo çështjet të cilat mund të ndodhin dhe të ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave me prioritet dhe zbatimin e secilit aktivitet. Mundësitë e humbura po ashtu konsiderohen si rrezik. Rreziqet të cilat e përcjellin arritjen e ndonjë prioriteti specifik mund të jenë të natyrave të ndryshme, si: 1) kufizimet financiare/buxhetore, 2) kufizimet në kapacitete (njerëzore); 3) arsye institucionale; 4) miratimi me kohë i ligjeve dhe rregulloreve; 5) bashkëpunimi ndërmjet njësive/institucioneve; 6) faktorët e jashtëm siç janë zhvillimet politike

### b) Analizat dhe vlerësimi i rrezikut

Vlerësimi i rrezikut duhet të gjykohet në bazë të katër shkallëve të rrezikut (i ulët, i mesëm, i konsiderueshëm, i lartë), duke e pasqyruar gjasën që ai të ndodh dhe ndikimin e rrezikut në lidhje me ndonjë aktivitet specifik. Në përputhje me Udhëzuesin për Mbështetjen Buxhetore nga BE-ja, për secilën shkallë të rrezikut është përcaktuar një ngjyrë specifike. Vendimi për nivelin e rrezikut për secilën pyetje duhet të arsyetohet me anë të një komenti/përshkrimi të shkurtë.

## 2. Masat për zbutjen e rrezikut

Zbutja e rreziqeve përfshin identifikimin e masave/veprimeve për zvogëlimin e gjasave që të ndodh një rrezik ose për zvogëlimin e ndikimit të ndonjë rreziku që ka ndodhur. Varësisht nga vlerësimi i rreziqeve, duhet të identifikohet reagimi i duhur ndaj atij rreziku përmes masave për identifikim dhe për zbutje. Në veçanti, institucioni duhet t'i identifikojë masat për t'ju përgjigjur rreziqeve të identifikuar.

## 3. Rolet dhe përgjegjësitë

Përkufizimi i njësisë/organit kryesor përgjegjës i cili do të sigurojë aplikimin e proceseve të duhura për menaxhimin e rreziqeve.

---

<sup>1</sup> EU Sector Budget Support Guideline, 2014